- **Ekonomia:** Bujqësia është një nga sektoret me të rëndësishëm të prodhimit në vend krahas sektorit të shërbimeve dhe ndërtimit si dhe burim kryesor i punësimit duke kontribuar në nivelin rreth 20% të PPB, dhe afërsisht 50% të numrit total të punësuarve. Sektore të tjera të rëndësishëm janë ndërtimi (10.41%), tregtia, transport, komunikacion, aktivitete profesionale rreth 23.02%, ndërsa së bashku industria e prodhimit dhe përpunimit dhe industria nxjerrëse përbejnë 9.79% të vlerës së shtuar. Sektoret kryesore që kontribuojnë në ekonominë e rajonit janë industria nxjerrëse dhe përpunuese (hidrokarburet), sektori i ndërtimit, sektori fason, bujqësia dhe tregtia me shumicë dhe pakicë dhe shërbime si hoteleri, restorante, dhe lloje të tjera të shërbimit. Në qarkun e Fierit operojnë 8.6% të numrit të përgjithshëm të bizneseve aktive në nivel kombëtar (ose 9,693 biznese) duke u renditur i dytë, mbas Tiranës, për numrin e bizneseve, nga të cilat rreth 83.9% e përben biznesi i vogël/ose person fizik me më pak se 7 punonjës. Sipas të dhënave statistikore,

vetem 1.31% te bizneseve aktive ne qarkun e Fierit jane me pronesi te huaj/ose te perbashket (ose 127 biznese), krahasuar me Durresin qe ka 5.4%, ose Tiranen me 7.5% ndermarrje te huaja dhe te perbashketa (3,746).


- **Demografia:** Popullsia e Bashkise Roskovec perbehet nga 32,1634 banore (dendesi 184 banore/km⁵). Qe nga viti 1990 – 2001, zona ka perjetuar nje rritje te popullsisë dhe me pas reduktim. Tendece tjeter ka qene zvogelimi i popullsisë rurale dhe rritja e popullsisë te zones urbane për shkak të migracionit nga zonat rurale por pavaresisht ketij ndryshimi, popullsia rurale eshte me e madhe se popullsia urbane. Zona e njesise administrative Kurjan ka pesuar zvogelimin me te theksuar te popullsisë me 30.4%, e ndjekuar nga njesia administrative Kuman me 23.3%, kurse fshati Ngjeqar ka pesuar reduktimin me dramatik (sot ne fshat kane mbetur një numër shumë i vogël banorësh).

Tabela 1 Shperndarja e banoreve sipas njesive administrative

Bashkia Roskovec	Popullsia ne 2015	Nr. Familjeve	Meshkuj (kryefamiljare)	Femra (kryefamiljare)
Njesite Administrative				
Roskovec	8911	2798	4562	423
Kuman	8573	2260	4471	324
Kurjan	5363	1419	2892	165
Strum	9316	2425	4918	338
Totali	32,163	8,902	16,843	1,250

Aktualisht popullsia urbane përbën 22.8% të popullsisë totale të zones. Roskoveci ka nje popullsi relativisht të re, grup moshë 18-55 vjeç llogaritet ne 4,806 banorë (ose afersisht 50 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë). Ne bashkine e Roskovecit jetojne rreth 8,902 familje me numer mesatar te banoreve per familje prej 3.5 banore (e barabarte me zonen e Tiranës)6. Dendesia mesatare e rajonit te Bashkise Roskovec eshte 184 banore per km², zona urbane (qyteti i Roskovecit) ka dendësi më të larte se densiteti mesatar i vendit (110.3 banorë/km²).

Tabela 2 Popullsia ne vite, 2001-2011



Burimi: INSTAT

- **Hidrografia :** Territori i Bashkise te Roskovecit ka kushte të përshtatshme për grumbullimin e ujërave nëntokësore (mbitokesore) te cilat krijohen (depozitohen) në liqenin e Kurjanit dhe në “Këneten e Zezë”. Ne pergjithesi rrjeti hidrografik siperfaqësor eshte i pasur, përveç dy liqeneve, territori ka nje rrjet të fuqishëm me kanale kullues në të gjithë zonën, te cilat lidhen me kolektorin kryesor të Myzeqesë qe derdhet ne detin Adriatik. Zona ka te ndertuar sistemin e ujitjes me ngritje mekanike nga lumi Seman, me synim shtimin e tyre ne te ardhmen. Semani eshte lumi i dyte per nga gjatesia ne Shqiperi, pas Drinit. Lumi fillon ne rrethin e Beratit dhe formohet nga bashkimi i dy lumenjve Osum dhe Devoll ne afersi te fshatit Kozare. Eshte i gjate rreth 281 km me pellg ujembledhes $5'649 \text{ km}^2$ dhe lartesi mesatare mbi nivelin e detit 863 m. Pasi pershkruan fushen e Myzeqese, shkarkon ujerat e tij ne detin Adriatik, ne jug te lagunes se Karavastase. Perpara se te arrije detin ai bashkohet me lumin e Gjanices i cili pershkon permes qytetin e Fierit. Duke marre ne konsiderate kushtet hidrometeorologjike, ujembledhesi i Semanit eshte me i varferi nga te gjithë lumenjte e Shqiperise, lidhur me ujerat nentokesore. Gjithashtu, rreshjet jane te pakta, mesatarisht $1'084 \text{ mm/vit}$. Prurja mesatare shumevjeçare eshte $95,7 \text{ m}^3/\text{s}$. Reth 60% e ujit sigurohet nga ujembledhesi i Devollit. Ujembledhesi i Semanit perbehet nga fusha bujqesore me mbulese te paket bimore qe i neneshtrohet nje erozioni te madh. Sasia e lendeve te ngurta qe transportohen per ne det nga Semani eshte afersisht 31,2 milione tone/vit. Ujerat kane mineralizim relativisht te larte prej 440 mg/l . Temperaturat e ujit luhaten nga $6,8^\circ\text{C}$ ne janar deri ne $25,5^\circ\text{C}$ ne gusht. Shtrati i lumit eshte i pasur me zhavorr dhe rere te imet, me gjeresi nga 100 deri 200 m. Lumi ka gjithmone uje te bollshem, por me rrjedhje relativisht te ngadalte. Brigjet jane argjilore te veshura me drure plepi ose shelgje.


Baseni i Semanit:

Sasia e pergjithshme e ujit qe shfrytezohet aktualisht eshte rreth 465-500 L/sek, rezervat me te medha shfrytezohen ne Turan. Koeficienti i shfrytezimit eshte $K=0.3-0.5$.


T - Temperatura e ujit ne dy fazat e monitorimit varion $T= 11.4-14$ grade Celsius, tregues brenda normes (norma 8-15, deri 20).

pH i UN-ne dy fazat e monitorimit varion 7.1-8.21, sipas normes se lejuar per uje te pijshem ky tregues eshte brenda normes se lejuar ($\text{Ph} = 6,5-8,5$. Ndryshimet ne dy fazat e monitorimit te vlerave te pH jane te vogla, ato variojne 0.09-0.11-0.12-0.22. Vlerat mesatare 5 vjecare te pH variojne 7.41-7.98.

Fp - Fortesia e pergjithshme ne dy fazat e monitorimit varion $Fp=13.58-16.60$ gjermane ne tregues brenda normes se lejuar, jane me ujera me fortesi mesatare. Ndryshime e Fp ne dy fazat e monitorimit jane te vogla, ato variojne nga 0-0.14-0.28-0.62⁰ gjermane.



Grafiku 1 pH per akiferin AL 500




Grafiku 2 Fp per akuiferin AL 500


Mp- Mineralizimi i pergjithshem ne dy fazat e monitorimit varion varion $Mp=402.74-539.16$ mg/l, jane tregues brenda normes se lejuar. Uji eshte i tipit hidrokarbonat- magnez -kalciumi ne Turan dhe hidrokarbonat- kalcium- magnezi ne Sheqeras, burimi Mancurisht hidrokarbonat- kalciumi.

Mth- Mbetja e thate ne dy fazat e monitorimit varion varion $Mth=256-390$ mg/l,

Na- Permbajtja e Natriumit ne dy fazat e monitorimit varion nga 1.15-16.33mg/l, permbajtja eshte brenda STASH dhe PML. Ndryshimet e Na ne dy fazat e monitorimit jane te vogla. Permbajtja mesatare 5 vjecare varion 1.49-21.04 mg/l.




Grafiku 3 Mp per akuiferi. AL 500




Grafiku 4 Na per akuiferin AL 500

Ca - Permbajtja e Kalciumit Ca ne dy fazat e monitorimit varion 37.07-100.2 mg/l. Permbajtja me e larte e Ca takohet ne burimin Mancurisht qe del nga gelqeroret. Permbajtja e Ca eshte brenda permbajtjes se rekomanduar dhe PML. Ndryshimet e Ca ne dy fazat e monitorimit jane te vogla, ato variojne 1-2-2.02-3 mg/l. Permbajtja mesatare 5 vjecare e kalciumit ne shpimet varion 34.73-67.35 mg/l.

Mg - Permbajtja e Magnezit Mg ne dy fazat e monitorimit varion 21.28-57.15 mg/l, permbajtja eshte nen permbajtjen e rekomanduar deri mbi PML. Ndryshimet e Mg ne dy fazat e monitorimit jane te vogla, ato variojne 0-1.81-1.82-1.84-3.04 mg/l. Permbajtja mesatare 5 vjecare varion 23.53-57.64 mg/l.



Grafiku 5 Ca per akuiferin AL 500



Grafiku 6 Mg per akuiferin AL 500

Fe - Permbajtja e Hekurit Fe ne dy fazat e monitorimit varion ne 0.01-0.08 mg/l. Takohet permbajtje ne normen e rekomanduar ne Bulgarec, Turan, ne burimin Mancurisht. Ndryshimet ne dy fazat e monitorimit variojne 0.02-0.03-0.04 mg/l deri 0.07 mg/l ne burimin Mancurisht. Permbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.028-0.057 mg/l.

NH4 – Ne fazen e pare te monitorimit nuk takohet permbajtje NH4. Ne fazen e dyte ta kohet permbajtje ne sasine 0.01mg/l ne Turan, Terova, Bulgarec, Sheqeras dhe ne burimin Mancurisht, permbajtja eshte nen permbajtjen maksimale te lejuar PML. Permbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.003-0.104 mg/l.




Fig- Fe per akuiferin AL 500




Fig- NH4 per akuiferin AL 500

Cl -Permbajtja e Klorit Cl ne dy fazat e monitorimit varion varion 12.43-39.05 mg/l, Permbajtja e Cl ne burimin Mancurisht varion 1.78-3.55mg/l dhe mesatarja eshte 2.66 mg/l. Permbajtja e Cl eshte ne permbajtjen e rekomanduar ne Bulgarec e Sheqeras dhe mbi permbajtjen rekomanduar por nen PML

ne Turan I.Terova. Ndryshimet e Mg ne dy fazat e monitorimit jane te vogla. Permbajtja mesatare 5 vjecare varion 12.78-36.74 mg/l.

SO₄ - Permbajtja e Sulfateve SO₄ ne dy fazat e monitorimit varion 2.49-12.88 mg/l ne TuranbulgarecSheqeras dhe ne burimin Mancurisht. permbajtje eshte brenda normes se rekomanduar. Ndryshimet e SO₄ ne dy fazat e monitorimit jane te vogla. Permbajtja mesatare 5 vjecare varion nga 3.3-15.64-110.75 mg/l.




Fig.- Cl per akuiferin AL 500




Fig.- SO4 per akuiferin AL 500

NO₃ -Permbajtja e Nitateve NO₃ ne dy fazat e monitorimit eshte e vogel, ajo varion nga 1.8-20.16 mg/l. Permbajtja eshte brenda normes se lejuar. Ndryshimet e NO₃ ne dy fazat e monitorimit jane te vogla, Permbajtja mesatare 5 vjecare 3.74-16.69 mg/l.

NO₂ - Ne fazen e pare te monitorimit takohet permbajtje te nitriteve ne sasine 0.01 mg/l ne Sheqeras I.Terova. Ne fazen e dyte te monitorimit takohet permbajtje e nitriteve ne sasine 0.04 mg/l ne Bulgarec. Ne sasine 0.01 mg/l. Nitrite takohen ne Turan, I.Terova dhe Sheqeras dhe ne burimin Mancurisht. Cfaqja e nitriteve lidhet me moszbatimin e zonave te mbrojtjes sanitare dhe eshte burim i afert ndotje.




Fig.- NO3 per akuiferin AL 500




Fig- NO2 per akuiferin AL 500

O₂ - Permbajtja e O₂ ne dy fazat e monitorimit varion 1.86-7.67 mg/l, permbajtja eshte me e vogel se norma (norma:- jo me pak se 8).

Analizat per mikroelemente - jane kryer ne Turan per Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd. Ne keto analiza ka permbajtje te mikroelementeve: Ni=0.-0.002 mg/l, Mn=0-0.001 mg/l, Zn=0.005-0.007 mg/l, Pb=0.013-0.04 mg/l, Cu=0.002-0.001 mg/l, Co=0.046-0.004 mg/l, Cr=0.018-0 mg/l, Cd=0-0.001mg/l. Permbajtja e mikroelementeve eshte ne permbajtjen e rekomanduar deri ne PML

- **Klima:** Klima eshte tipike mesdhetare, me dimer te bute dhe te lagesht dhe vere te nxehte e te thate. Kjo situatë ndikohet nga masat ajrore detare per shkak te distances relativisht te shkurter nga deti Adriatik (rreth 25 km). Nga ana lindore dhe jugore vargmalet e larta e pengojne depertimin e klimes se ftohte kontinentale. Temperatura mesatare vjetore luhetet ne 14-15 °C ndersa temperatura e Janarit rreth 5°C. Reshjet bien kryesisht ne forme shiu ndersa debora eshte dukuri e rralle. Gjate veres bien vetem 1/10 e reshjeve vjetore gje qe shtron nevojën e ujitjes se tokave bujqesore. Per kete arsye jane ndertuar disa liqene artificiale si ujembledhesi i Zharrezes, Lalarit, Ruzhdies etj.
- **Pershkrimi geologo-geomorfologjik i zones.** Rajoni i Fierit (brenda dhe ne periferi te vijes se verdhe) perfaqesohet nga depozitime te shkembinjëve rrenjesore me moshe Pliocenike-pjesa me

e siperme e ashtuquajtura “Suita Rrogozhina” dhe depozitime te shkembijnje mbulesor qe perfshijne formimet e sotme me moshe Kuaternare, te formuara ne kontinent gjate Holocenit.

✓ Shkembijnje Rrenjesor-Plioceni – N_2

Shkembijnje rrenjesor te pliocenit kane perhapje te kufizuar ne siperfaqe dhe jane te perfaqesuar vetem nga shkembijnje e “Suites Rrogozhina” pjesa e siperme e saj.

✓ Suita Rrogozhina – N_2^R

Perhapen ne pjesen jugore dhe jugperendimore ne rajonet e kodrave prane fshatit Mbyet dhe Zhupan. Gjurmjet e tyre zgjaten dhe ne kodrat e qytetit.

Bazuar ne studimet e kryera (Sota T. etj. 1978) ato jane te diferencuara (Fig. Nr. 1, 2) ne dy pako litologjike.

- Pakua Ranoro-alevrolitore-argjilore.
- Pakua Ranoro-konglomeratike.

✓ Pakua Ranoro-Alevrolito-Argjilore – $N_2^R(T)$

Ne siperfaqe jane te perhapura ne rajonin e Mbyetit si pjese perberese e hundes strukturale te Krapsit si dhe te mbylljes jugore te antiklinalit te Ardenices.

Ndertothen nga shkembijnje argjilo-alevrolitor te nderthurur nga shtresa e thjerza te ranoreve kokriz vegjel deri kokriz imet, te çimentuar dobet.

✓ Pakua Ranoro - Konglomeratike $N_2^R(II)$

Takohet ne pjesen jugore te rajonit, ne jug te Zhupanit. Ato vendosen normalisht mbi pakon ranoro-alevrolito-argjilore nepermjet nje horizonti ranoro-konglomeratik qe ndryshon ne shtrirje deri ne konglomerat masiv.

Ranoret jane kokriz ndryshem, te çimentuar dobet deri te shkrijet.

Alevrolitet kalojne edhe ne argjila dhe alternohen me ranoret.

Trashesia e depozitimeve te suites Rrogozhina ne rajon mendohet rreth 400 m.

Bazuar ne studimet tematike (Guri S. etj., 2002) perberjet litofaciale te Pliocenit te siperme, qe perhapen nen depozitimet mbulesore te Kuaternarit, per rajonin ne studim dhe prane tij paraqiten ne Fig. 6, 7.

✓ Shkembijnje Mbulesor – Kuaternari – Q

Ne pergjithesi jane shkembijnj te pa konsoliduar, perfaqesojne Seksionin Halocen dhe vendosen me mospajtim e diskordance kendore mbi depozitimet e nenshtrira te pliocenit.

✓ Holocen – Q_2

Shkembijnje e Holocenit mbulojne gati te tere siperfaqen e rajonit te qytetit dhe i perkasin pjeses se siperme te tij dhe jane te formuara ne kontinent. Ato jane te perfaqesuara nga formime eluvionale e deluvionale si dhe formime aluvionale e aluvionalo-kenetore. Pjesa prane siperfaqesore e tyre kthehet ne toke buke apo vegjetale.

✓ Eluvionet Dhe Deluvionet – Q_2^{el-del}

Kryesisht jane te perhapura prane faqeve te kodrave me shkembijnje rrenjesor te suites Rogozhina, duke formuar trashesi 2-3 e deri 4-5 m drejt fushes ndertohen ato reduktohen me formimet aluvionale. Perfaqesohen nga dhera me guralec e copa te perziera me suargjila e surera. Suargjilat jane pak te lageta, ne gjendje plastike dhe mesatarisht te ngjeshura, ndersa surerat paraqiten kokriz imet deri kokriz ndryshem.

✓ Aluvionet Dhe Aluvionet Kenetore – Q_2^{al}

Kane perhapjen me te madhe dhe shtrihen pergjate luginave te lumenjeve Seman dhe Gjanica duke formuar nje fushe te gjere. Trashesia e tyre ndryshon nga disa metra deri ne rreth 100 m (Fieri-3) edhe me shume (Fig. 5). Aluvionet jane te perfaqesuara nga nderthurje shtresash e thjerrzash te suargjilave e surerave me rera e zhavore. Prane shtrateve te rrjedhjes se lumit shpesh ato perfaqesohen prej surerave, rera lumi e deri ne zhavore koker mesem, me fraksione zhavori e breza rerash te imta te alternuara me suargjila te ngopura me uje e mesatarisht te ngjeshura.

Ne rajonet prane ish kenetave (Fig. 1,4) takohen argjila gri te erreta, me lageshti, deri te rrjedheshme e te pangjeshura; me permbajtje mbeturinash bimore torfe e lyme argjilore.

Kufi te qarte midis formimeve aluviale e atyre aluvialo-kenetore eshte veshtire te hiqet.

➤ **Zhvillimi Tektonik**

Ne aspektin tektonik rajoni i Qytetit Fierit me rrethinat eshte pjese e Ultesires Pranadriatike pjesa jugore e saj, perfshire edhe depozitimet e Kuarternarit, qe vendosen me mospajtime deri kendor mbi depozitimet e Pliocenit, por qe sherbejne edhe si nje mbulesa e njesive strukturale antiklinale e sinklinale te Ultesires Pranadriatike.

Per depozitimet e Kuarternarit nuk dallohen ne siperfaqe element te renies se shtresave, por gjithmone jane interpretuar me renie horizontale. Prane siperfaqeve te denudimit dhe ne kalimet faciale te tyre mund te gjenden element te renies, por qe nuk mund te perfaqesojne si element renie meqenese nuk ka marre fund procesi diagjenezes.

Bazuar ne studimet tematike (Guri S. etj. 2002) nepermjet te dhenave sizmike, te dhenave te shpimit te puseve eshte interpretuar dyshemeja e depozitimeve te Kuarternarit. Ne relievi i dyshemese se kuarternarit paraqitet i ondular, me nje kurrizore ne vazhdimin jugor te struktures antiklinale te Ardenices si dhe te vazhdimet verior te Hundes se Krapsit, qe zhyten drejt veriperendimit dhe

lindje-veri-lindjes me nje thellesi zhytje 100 m. Qyteti i Fierit pozicionohet afersisht prane kesaj qafe paksa ne jug te saj, ne zhytjen veriore te hundes strukturale te Krapsit.

Trashesite e depozitimeve te Kuaternarit mbulojne strukturat neogenike sic jane ato te vazhdimit drejt veriut te Hundes antiklinale te Krapsit dhe vazhdimit jugor te Antiklinalit te Ardenices, te formuara si produkt orogjenizuese dhe qe shprehin rinovimin e proceseve te vjetra tektonike. Ato shoqerohen edhe me shkeputje tektonike te tipeve te ndryshme si mbihypje e kundrahypje gjatesore e terthore, por qe nuk dalin ne siperfaqe. Evidentimi i tyre merr rendesi meqenese ndikojne ne sizmicitetin e rajonit sic eshte prishja e krahut lindor te struktures se Ardenices apo ajo ne krahun perendimor te hundes se Krapsit.

➤ **Kushtet Hidrogeologjike**

Rajoni i Fierit me rrethinat e tij perfshihet ne pellgun hidrogeologjik te Ultesires Perendimore i pasur me ujra nentokesor e kondicionuar kjo me prezencen e shkembinjave magazinues, me kushtet e favorshme klimatike me reshje ne sasi te kenaqeshme si dhe prania e lumenjeve Semani e Gjanica. Bazuar ne kriteret litologo-stratigrafike mund te veçohen dy komplekse ujembajtese :

- Kompleksi ujembajtes i depozitimeve te Kuaternarit.
- Kompleksi ujembajtes i depozitimeve te Pliocenit – Suita Rrogozhina.

✓ Kompleksi ujembajtes i depozitimeve te shkrufta te Kuaternarit

Perhapet ne njesine gjeomorfologjike fushore dhe eshte i lidhur me pranine e shkembinjave magazinues surera, rera e zhavore aluviale me pershkueshmeri te mire qe jane te mbuluar kudo nga suargjila me pershkueshmeri te ulet. Perhapja vertikale dhe horizontale e shkembinjave magazinues dhe atyre izolues eshte evidente dhe e mundeshme per te gjithë prerjen e kuaternarit dhe eshte ne vartesi te energjise dhe sasise se prurjeve te lumenjeve Seman e Gjanica, pozicionit qe kane patur keta lumenj gjate gjithë kohes se ekzistences e zhvillimit te tyre.

Ujrat nentokesore pa presion i rera dhe surerave aluviale perbejne kryesisht horizontin e pare ujembajtes nga siperfaqja e tokes. Ai shtrihet ne te gjithë njesine gjeomorfologjike fushore dhe karakterizohet nga nje pershkueshmeri e larte, perhapje e gjere dhe ujembajtje e madhe.

Nivelet me te siperme te ketyre ujrave qe i perkasin ujrave freatik te siperfaqes, ne pergjithesi jane ne vartesi te prurjeve te lumenjeve si rezultat i reshjeve atmosferike. Thellesia e takimit te tyre eshte nga metrat e para deri ne thellesi 5 m. Ujrat jane te pijshem, por me rezerva te kufizuara (sipas madhesis se rezervuarit). Shpesh here gjate veres thahen veçanerisht ato prane lumenjeve e ne thellesite deri 2 m nga siperfaqja e tokes.

Nivele te tjere ujembajtes jane horizontet e rera, surerave e sidomos te zhavoreve qe mund te konsiderohen te varosur, e qe mbulohen nga suargjila me pershkueshmeri te ulet. Keto nivele jane te pritshme gjate gjithë trashesise se aluvioneve te Kuaternarit dhe jane te ushqyer si nga ujrat e lumit ashtu, dhe nga kontakti direkt i tyre me zhavoret apo ranoret e depozitimeve te Suites Rrogozhina.

Zhavoret aluvial kane perberje copezore e kokrizore heterogjene, me trashamane ne zonat e ushqimit nga lumi dhe mandej me larg rera e surerat e deri suargjilat. Vetite filtruese, ujembajtese dhe cilesia e ujit te zhavoreve shkojne ne perputhje te plote me ndryshimin e granulometrise se tyre nga zona e ushqimit ne zonen e drenimit d.m.th. pershkueshmeria, ujembajtja dhe cilesia e ujit ulin vlerat ne kete drejtim.

✓ Kompleksi ujembajtes i depozitimeve te Pliocenit – Suita Rrogozhina

Konglomeratet dhe ranoret e Suites Rrogozhina jane shkembinjte me vlere me te madhe praktike per furnizim me uje nga ujrat nentokesor. Ata formojne disa horizonte apo shtresa ujembajtese me trashesi 5-20 m te ndara midis tyre prej shtresave argjilore e argjilo-alevrolitore me trashesi disa metra.

Vetit filtruese te konglomerateve dhe ranoreve varen nga poroziteti dhe shkalla e çimentimit te tyre. Ata me çimentim te dobet deri te shkrifet jane me veti me te larta filtruese dhe ne pergjithesi shkembinjte copezore te Suites Rrogozhina karakterizohen me veti filtruese dhe ujembajtje mesatare. Cilesite fiziko-kimike te ujrave nentokesor qe lidhen me keta shkembinj jane ne pergjithesi te mira. Jane ujra te embla qe i plotesojne kerkesat e perdorimit per uje te pijshem. Ujrat nentokesor te konglomerateve ushqehen nga filtrimi i reshjeve atmosferike dhe tendenca e pergjitheshme e drenimit te tyre eshte deti Adriatik.

VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ndikimet negative ne mjedis nga aktiviteti qe ushtrohet vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete raport. Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me aktivitetin e tregtimit se bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

- **Shkarkimet ne uje**

Gjate zhvillimit te aktivitetit te magazinimit dhe tregtimit te karburantit, nuk kemi shkarkime te ujrave te gjeneruara ne ujrat siperfaqesor. Ujrat qe gjenerohen nga ambientet higjeno-sanitar grumbullohen ne gropen septike te ndertuar nga shoqeria sipas kushteve teknike. Gropa septike pastrohet periodikisht nga kompanit e licencuara per trajtimin e ujit te ndotur.

Ujrat e pastrimit te ambienteve te aktivitetit dhe te shiut grumbullohen nepermjet sistemit te kunetave te mbuluara me zgare metalike dhe prej andej shkarkohen ne kanalin kullues te ujrave te bardha te zones. Keto ujra nuk kane prani te karburantit pasi subjekti eshte shume i kujdesshem ne magazinimin dhe tregtimin e karburantit duke shmangur me rigorozitet rrjedhjen e tyre ne sheshet e ambienteve te aktivitetit. Ne rastin e rrjedhjeve aksidentale te karburantit ne sheshet e ambientit te aktivitetit, menaxhimi i tyre do te behet nepermjet hedhjes se reres mbi siperfaqen e derdhur te karburantit. Rera e perzier me karburant do te hidhet ne fuci dhe prej andej do te transportohet drejt firmave te trajtimit te tyre. Nga derdhja aksidentale nuk kemi depertim te tyre ne ujrat nentokesore pasi sheshi eshte i shtruar me pllaka betoni.

- **Emetimet ne ajer**

Nga proceset e magazinimit dhe furnizimit me karburant, kemi gjenerimit te gazrave dhe avujve te demshem te cilat jane tipike per procese te tilla pune per ruajtjen e tyre. Gjithashtu te pranishme ne terminalet e shkarkimit jane edhe aromat e gazit (squfur) te cilat jane te pashmangshme edhe pse shoqeria ka marre masat e nevojshme per reduktimin ne maksimum te ketyre shkarkimeve. Ne rastin e rrjedhjeve aksidentale subjekti ka mar masa per menaxhimin e rrjedhjeve nepermjet teknikave me te mira per shmangjen maksimale te ndotjes se ujrave nentokesore.

- **Ndikimet ne toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te kemi ndikime ne toke pasi sheshi i ambienteve te magazinimit dhe tregtimit me karburant, eshte i shtruar me pllaka betoni duke shmangur depertimin e karburantit ne rast aksidentesh ne shtresat e tokes. Per sa i perket mbetjeve qe gjenerohen nga aktiviteti jetesor i punetoreve, grumbullimi i tyre dhe diferencimi behet nepermjet sistemit te koshave te vendosur ne ambientet e aktivitetit.

- **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe gjenerohen ne mjedisin ne fjale, vijne kryesisht nga procesi i shperndarjes dhe magazinimit te karburantit. Keto zhurma jane momentale deri ne perfundim te magazinimit dhe furnizimit te automjeteve me karburant.

Vleresimet per zhvillimin e aktiviteve te tilla, rezultojne se gjenerimi i zhurmave eshte ne nivele te ulta dhe qe nuk ndikojne ne mjedisin e zones perreth dhe punonjesit. Ndikime te tilla jane ne orareret kur ka levizje te shumta te automjeteve.

- **Ndikimet ne flore/faun**

Aktiviteti zhvillohet brenda konturit te siperfaqes se aktivitetit duke mos ndikuar aspak ne floren dhe faunen e zones. Perkundrazi ne konturet rrethuese te prones eshte mbjelle breze me bimesi duke mbrojtur zonen perreth nga pluhurat dhe aromat e pa kendeshme qe gjenerohen nga procesi i magazinimit dhe furnizimit me karburant.

- **Mbetjet e prodhuara**

Mbetjeve qe gjenerohen nga ky aktivitet jane mbetjet nga aktiviteti jetesor i punetoreve, grumbullimi i tyre dhe diferencimi behet nepermjet sistemit te koshave te vendosur ne ambientet e objektit.

MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Masat e propozuara per funksionimin efcient dhe te sigurt te punes ne aktivitetin e tregtimit te karburantit:

- ✓ Te mirembahen mjediset e gjelberuar ne menyre te perhershme dhe te mbillen edhe bime dekorative autoktone ne kushte artificiale per te rritur koeficientin e gjelberimit.
- ✓ Te shmanget ne maksimum perdorimi i mjeteve te transportit kur nuk eshte e nevojshme dhe te reduktohen zhurmat ne oret e vona.
- ✓ Te kryhet rrethimi i objektit dhe linjes se depozitimit te karburanteve dhe te vendosen tabela paralajmeruese per rreziqet per kalimtare dhe punonjesit.
- ✓ Te reduktohet qarkullimi ne oret e pikut te trafikut, per te mos krijuar trafik te renduar ne zone.
- ✓ Te mos perdoren borite e mjeteve ne qendrat e banuara dhe qarkullimi te kryhet me shpejtesi te ulet.
- ✓ Te vendosen kontenier per mbajtjen paster te ambjenteve nga mbetjet urbane per numrin e punonjesve.
- ✓ Mbjetet e rrezikshme me permbajtje hidrokarbure te rikuperohen dhe asgjesohen nga subjekte te licencuara.
- ✓ Investitori te respektoje detyrimet e vendosura ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga AKM.
- ✓ Subjekti te respektoje te gjitha masat/normat/planet/shkarkimet qe do te deklarohen ne formular-Kerkese per Leje Mjedisore Tipi B.
- ✓ Subjekti te jete ne dijeni dhe te azhornohet per kuadrin ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij.
- ✓ Subjekti te respektoje dhe zbatoje kushtet teknike ne objekt per mbrojtjen nga zjarri dhe te krijojte infrastrukturen e nevojshme per zjarrefikset.
- ✓ Te kryhet monitorimi i indikatorëve te mjedisit sipas ligjeve ne fuqi.
- ✓ Eshte detyre e zbatuesve te projektit te integrojne elementet e domosdoshem te propozuar per parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative ne mjedis, shendet dhe aspektin social.
- ✓ Eshte detyre e Njesise Vendore gjithashtu te zbatoje rigorozisht detyrimet e percaktuara per te garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit.
- ✓ Eshte detyre e te gjith kontraktoreve e nenkontraktoreve te ndryshem si gjate fazes se depozitimit te karburanteve te zbatojne me kujdes detyrimet perkatese te parashikuara me siper.

Masa lehtesuese te kerkuara

- ✓ Do te behet nje menaxhim sa me me efcient te energjise elektrike, kjo do te coj ne uljen e ndotjeve termike te mikroklimes se zones si dhe kursim te energjise elektrike nga perdorimi i makinerive/impianti me efcience.

- ✓ Percaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe paisja e vend-parkimeve me sinjalistiken perkatese.
- ✓ Subjekti të kryej aktivitetin për shpërndarjen dhe magazinimin e karburantit vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon në zotërim.
- ✓ Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- ✓ Do të instalohet sistemi i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelberim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brendshme gjatë periudhës Maj-Tetor.
- ✓ Linja e impiantit të instaluar në objekt, do të koluadohet në mënyrë periodike nga teknike të specializuara dhe certifikuar për të tilla procese.
- ✓ Veglat/Pajisjet/Makinërite të punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve depozitimit të karburanteve.
- ✓ Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me boje higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- ✓ Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lende të aballazheve, letra/kartona, si dhe lende organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njësia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- ✓ Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave të pastrimit dhe ujit të shiut në këto objekt ose në mjedisin përreth drejt mjediseve të gjeberuara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjelberuar përreth do të jetë nën kujdesin e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- ✓ Rrjeti elektrik është tërësisht i shpërndarë ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike.
- ✓ Zona ku do të realizohen operacioni i magazinimit dhe furnizimit me karburant është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e pa autorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- ✓ Janë ndërmarre të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundër zjarrit. Për të mbrojtur kunder zjarrit të mundshëm që mund të bëjë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së depozitimit të karburanteve.
- ✓ Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrefiksive, etj.
- ✓ Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafit përgjegjës për operimin e punës në objektin e magazinimit dhe furnizimit me karburant.